

VENDIM
Nr.540, datë 4.12.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “MEMALIAJ”
SUBJEKTIT FIZIK: VLADIMIR SHEHU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Vladimir Shehu, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Memaliajt.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku